



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Departamenti i Arsimit Parauniversitar
Divizioni i Arsimit Gjithpërfshirës

DORACAK PËR MËSIMDHËNËSIT DHE PROFESIONISTËT E ARSIMIT

MBROJTJA E FËMIJËVE NGA TRAFIKIMI:
Roli i shkollës



MBROJTJA E FËMIJËVE NGA TRAFIKIMI

Roli i shkollës

Ky doracak është përgatitur me mbështetjen financiare të Projektit “Forcimi i Veprimeve Anti-trafikim”, zbatuar nga Këshilli i Evropës dhe bashkëfinancuar nga Belgjika, Gjermania, Irlanda, Norvegjia dhe Këshilli i Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë opinionin zyrtar të ndonjërës prej palëve.

PËRMBAJTJA

1. TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE	7
- Çka nënkupton trafikimi i qenieve njerëzore?	7
- Faktorët e trafikimit të qenieve njerëzore	10
2. TRAFIKIMI I FËMIJËVE	12
3. INDIKATORËT E ZBULIMIT DHE IDENTIFIKIMIT PRELIMINAR TË FËMIJËVE- VIKTIMA POTENCIALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE	17
4. ROLI I SHKOLLËS NË PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE	26
5. PARANDALIMI	28
6. PROCEDURAT E DENONCIMIT TË RASTIT KUR EKZISTON DYSHIMI SE EKZISTON VIKTIMA POTENCIALE E TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE	33
7. NUMRAT KONTAKTUES PËR REFERIM	36
8. KORNIZA LIGJORE NË FUSHËN A PARANDALIMIT TË TRAFIKIMIT ME NJERËZ NË KOSOVË	37

PARATHËNIE

Ky doracak është hartuar si pjesë e nismës për ndërgjegjësimin dhe forcimin e njohurive të kuadrit arsimor në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, në veçanti trafikimin e fëmijëve, si dhe rolin e institucionit shkollor në parandalimin e këtij fenomeni dhe mbështetjen për riintegrim të viktimave të trafikimit.

Ky doracak është hartuar me iniciativën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nga grupi punues ndërinstitucional i krijuar nga MASHTI dhe me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës “Forcimi i Veprimeve Anti-trafikim”.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka mandat që të parandalojë trafikimin përmes arsimit, kurrikulave, qasjeve ndërdisiplinore dhe aktiviteteve të ndryshme jashtëkurrikulare që trajtohen nga institucioni shkollor. Ministria trajton rastet e braktisjes së shkollës, promovon të drejtën e shkollimit dhe mbështet ri-integrimin e personave të trafikuar.

Veprimet kundër trafikimit në Kosovë rregullohen me standardet ekzistuese ndërkombëtare dhe legjislacionin vendor. Kosova ka të themeluar mekanizmin kombëtar të referimit, strukturë kjo bashkëpunuese nëpërmjet së cilës institucionet shtetërore i përbushin obligimet për t’i mbrojtur viktimat e trafikimit, promovuar të drejtat e viktimës dhe

koordinojnë përpjekjet e tyre përgjatë gjithë ciklit të shërbimeve, duke përfshirë këtu; parandalimin, luftimin dhe riintegrimin e viktimave. Sipas kornizës ligjore të Kosovës, roli i shkollës në trajtimin e kësaj dukurie negative është i lidhur me parandalimin, identifikimin, raportimin dhe riintegrimin e viktimave.

Ky doracak përmban disa pjesë të ndërlidhura që pasqyrojnë njohuritë dhe shkathtësitë që mësuesit dhe stafi profesional kanë nevojë për të qenë në gjendje të identifikojnë fëmijët që janë viktimë të mundshme të trafikimit të fëmijëve.

Ai përmban informacion mbi fenomenin e trafikimit dhe ofron njohuri për mësimdhënësit dhe stafin e shkollës në parandalimin, identifikimin, referimin dhe mbështetjen e viktimave të trafikimit.

Prishtinë, 2023

1. TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Trafikimi i qenieve njerëzore është problem global i cili kërcënon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Çdokush mund të jetë viktimë e trafikimit, por më të rrezikuarit janë fëmijët, vajzat dhe gratë, por edhe (në një numër më të vogël) burrat. Miliona njerëz shfrytëzohen për prostitucion, kërkim lëmoshe, punë të detyruar dhe forma të tjera më të rënda të shfrytëzimit, duke përfshirë heqjen e organeve ose qelizave të njeriut.

Përballë kësaj situate, vende të ndryshme kanë ndërmarrë hapa për të krijuar politika adekuate për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni dhe ofrimin e mbrojtjes dhe shërbimeve për viktimat e trafikimit dhe atyre të supozuara.

Çka nënkupton trafikimi i qenieve njerëzore?

Sipas Nenit 4 të Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore,

“trafikimi i qenieve njerëzore” [nënkupton] rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të kanosjes ose të

përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.



“Shfrytëzimi” [përfshin], të paktën, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve.



Pëlqimi i viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh, nëse është marrë me metodat e sipërpërmendura.

Elementet e trafikimit

Mënyrat me anë të së cilave viktimat e mundshme rekrutohen dhe mashtrohen janë:

- përmes rekrutuesve individualë: njerëz të lagjes, miq të ngushtë që ofrojnë shërbime të ndryshme (kryesisht mundësi punësimi);
- përmes rrjeteve joformale që mund të përfshijnë edhe anëtarë të familjes, të afërm, (me oferta martesë);
- nëpërmjet reklamave në media për profesione, si ta zëmë: kameriere, këngëtare, dado, punëtore sezone brenda dhe jashtë vendit, pastaj rekrutime dhe mashtrime përmes internetit;

- përmes mediave sociale dhe internetit të cilat përdoren edhe nga grupet kriminale për të rekrutuar viktime, për t'i kontrolluar ato, por edhe për t'i shfrytëzuar përmes teknologjisë.
- përmes rrëmbimit të papritur e të egër. Trafikimi i qenieve njerëzore mund të bëhet brenda kufijve të vendit të vet - vendit të origjinës - trafikim i brendshëm, ose jashtë vendit - trafikim ndërkombëtar të qenieve njerëzore.

Në Kosovë, trafikimi me qenie njerëzore është veprë penale. Dënimi minimal për trafikantët në Kodin Penal të Kosovës është 5 vjet burgim, ndërsa dënimi maksimal në rrethana të veçanta është dënimi me burgim të përjetshëm.

Sipas ligjit, viktimat që detyrohen të kryejnë veprime të paligjshme nga trafikantët nuk dënohen për ato vepra të kryera si rezultat i trafikimit.



FOTOGRAFIA 1: *Trafikimi i qenieve njerëzore*

Faktorët e trafikimit të qenieve njerëzore

Faktorë të ndryshëm kontribuojnë në zhvillimin e aktiviteteve kriminale, përfshirë trafikimin, si p.sh.; faktorët politikë, ekonomikë, socialë dhe teknologjikë.

Një faktor i rëndësishëm socio-ekonomik është zhvillimi i ulët ekonomik i Kosovës, i cili shoqërohet me një nivel të lartë të papunësisë, veçanërisht në mesin e të rinjve, vajzave dhe grave si dhe grupeve të marginalizuara. Situata ekonomike është e lidhur ngushtë me çështjet sociale, si; problemet familjare, divorci, braktisja e fëmijëve dhe niveli i ulët arsimor, të cilat rrisin rrezikun për t'u bërë shënjestër e trafikimit.

Përveç kësaj, grupet kriminale në mbarë botën përfitojnë nga situata të paqëndrueshme politike dhe Kosova, si vend në tranzicion, nuk ka qenë immune ndaj këtij problemi. Megjithatë, pavarësisht tensioneve të vazhdueshme, Kosova ka krijuar korniza institucionale dhe ligjore për të luftuar trafikimin, duke përfshirë një 'Strategji Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore', e cila ka një Plan Veprimi për të koordinuar përpjekjet ndër-institucionale.


Faktori teknologjik ka luajtur gjithashtu rol në lehtësimin e aktiviteteve kriminale, përfshirë trafikimin. Në Kosovë, përdorimi i gjerë i internetit, veçanërisht i mediave sociale, ofron një platformë për grupet kriminale për të rekrutuar, kontrolluar dhe shfrytëzuar viktimat, përmes teknologjisë.

Faktorët e lartpërmendur mund të klasifikohen në dy grupe:

- faktorët shtytës, duke përfshirë varfërinë në vendet/rajonet e origjinës, tranzicionin ekonomik, mungesën e arsimit, mungesën e informacionit në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, mundësitë e pamjaftueshme punësimi në vendin e vet, familjet jofunksionale, diskriminimin gjinor në tregun e punës, të gjitha format e dhunës duke përfshirë në familje, mungesën e mundësive për migrim legal.

- faktorët tërheqës, duke përfshirë dëshirën për punësim, paga dhe përfitime më të mira, mbështetje financiare për familjet e viktimave, qasje në përfitime të caktuara, kërkim arsimor cilësor, dëshirën për jetë aventureske dhe emocionuese, ofertat “tërheqëse” për martesë, njohjen me vende dhe kultura të reja, përvetësimin më të mirë të statusit social, e kështu me radhë.

FIGURA 2: Faktorët shtytës e tërheqës të trafikimit të qenieve njerëzore



2. TRAFIKIMI I FËMIJËVE

Fëmijët janë kategoria më e cënueshme e synuar nga trafikantët, për shkak të aftësive të tyre të kufizuara psikologjike dhe fizike për të identifikuar situata dhe veprime të rrezikshme dhe për t'u mbrojtur nga rreziku. Për të parandaluar këtë, zbulimi dhe identifikimi i hershëm i viktimave të mundshme në mesin e nxënësve është jetik.

Trafikimi i fëmijëve me fëmijë ka pasoja të rënda që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin, zhvillimin psiko-fizik, edukimin dhe mirëqenien e përgjithshme. Trafikimi i fëmijëve është vepër penale. Karakteristikat specifike të trafikimit të fëmijëve kërkojnë edukimin dhe trajnimin e mësimdhënësve dhe personelit tjetër arsimor përkatës në lidhje me procedurat e veçanta për mbrojtjen e fëmijëve dhe referimin e tyre në asistencën e duhur.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, shprehja "trafikim me njerëz" nënkupton: rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e

personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.

Trafikimi i fëmijëve sipas Kodit Penal përbën: rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pranimin e një fëmije me qëllim shfrytëzimit e tij dhe konsiderohet si “trafikim me njerëz”.

Pëlqimi i viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore për qëllim shfrytëzimi nuk merret parasysh kur ndaj kësaj viktime është përdorur një nga mjetet e përcaktuara më sipër në këtë paragraf.

Ndërsa, mosndëshkueshmëria e viktimave për veprat që janë detyruar t’i kryejnë gjatë kohës sa kanë qenë viktime të trafikimit është rregulluar me legjislacionin në fuqi. Viktimat e trafikimit nuk dënohen për veprat të cilat kanë qenë të detyruar t’i kryejnë.

Llojet e trafikimit të fëmijëve

Fëmijët trafikohen për:

- shfrytëzim seksual,
- punë ose shërbim të detyruar,
- skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë,
- veprimtari shërbyese,
- martesë e detyruar,
- kërkim lëmoshë,
- birësim të paligjshëm,
- shtrëngim për të kryer krime, dhe
- marrje të paligjshme të organeve.

1. SHFRYTËZIMI I DETYRUAR PËR SHËRBIME SEKSUALE

Shfrytëzimi i viktimave që detyrohen të kryejnë marrëdhënie seksuale kundër vullnetit të tyre.

2. PORNOGRAFI

Shfaqja apo përfshirja e fëmijëve në aktivitete reale ose të simuluar eksplicite seksuale, ose shfaqja e organeve gjenitale të fëmijëve.

3. LËMOSHË- KËRKIMI

Detyrimi i fëmijëve të kryejnë aktivitete të kërkimit të lëmoshës në rrugë, sheshe apo vende të tjera, si; lokale nate, kafene etj.

4. PUNA OSE SHËRBIMET E DETYRUARA, SI NË AKTIVITETET E MËPOSHTME:

- punë në rrugë (larja e xhamave të automjeteve, shitja e gjërave në rrugë),
- punë në bujqësi (punë sezonale; vjelje frutash dhe perimesh),
- veprimtari shërbyese në objekte hotelerie (kameriere, shoqëruese tavoline me të ftuar, kërcimtare),
- punë në ferma (rritja dhe mbarështimi i kafshëve shtëpiake), - në ndërtim, në sektorin e minierave, në fabrika.
- Punë në amvisëri

5. SKLLAVËRIA OSE PRAKTIKA TË NGJASHME ME SKLLAVËRINË:

Skllavëria nuk është domosdoshmërisht trafikim por mund të ndërlidhet me të, përfshin rastet kur njerëzit mbahen në kushte të vështira jetese, nën privimin e lirisë dhe detyrohen të kryejnë punë të ndryshme, duke përfshirë edhe punët e rënda.

6. HEQJA E ORGANEVE OSE QELIZAVE

Përdorimi i organeve dhe qelizave për trafikim bëhet pa pëlqimin e viktimave, ku trafikantët marrin organet e viktimave nëpërmjet mashtrimit ose detyrimit, ose duke i ekspozuar ato në një situatë ku viktimat janë të pafuqishme për të reaguar.

7. MARTESA E DETYRUAR

Ky lloj trafikimi nënkupton martesën e detyruar të fëmijëve. Përveç detyrimit për martesë, fëmijët mund të bëhen viktime edhe për qëllime të skllavërisë, kërkimit të lëmshës, kryerjes së aktiviteteve kriminale apo të ngjashme.

Disa nga karakteristikat që i vendosin fëmijët në një situatë delikate dhe në rrezik trafikimi janë:

- vijnë nga familje në gjendje të vështirë ekonomike;
- pa prindër ose pa përkujdesje prindërore dhe fëmijët në situatë rruge (fëmijët e rrugës);
- ballafaqohen me probleme në familje;
- të përjashtuar nga arsimit;
- të painformuar për rreziqet dhe pasojat e trafikimit dhe
- me nevoja të veçanta.

Duke iu referuar karakteristikave të lartshënuara dhe në varësi të gjinisë dhe moshës së fëmijëve, ata mund të jenë të cenueshëm ndaj formave të ndryshme të trafikimit, p.sh.:

- vajzat shpesh përdoren për prostitucion, pornografi dhe aktivitete të tjera seksuale;
- djemtë përdoren për shërbime ose punë artizanale, ose veprimtari të ngjashme, si dhe në bujqësi;

- adoleshentët përdoren për të kryer krime; fëmijët më të vegjël përdoren për punët e shtëpisë, lëmshë- kërkimin dhe delikuencën;
- foshnjat dhe të sapolindurit janë të përshtatshëm për birësim dhe trafikim me njerëz; dhe
- të gjithë, pavarësisht nga gjinia dhe mosha, mund të shfrytëzohen për marrjen e paligjshme të organeve.

Pasoja të trafikimit të fëmijëve

Trafikimi i fëmijëve është shkelje e rëndë e të drejtave të fëmijëve. Fëmijët viktimë janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të përditshme, duke përfshirë detyrimin fizik dhe psikologjik, abuzimin dhe dhunën e përditshme. Zhvillimi i tyre psikofizik, shëndeti dhe edukimi janë në rrezik. Shfaqja e çrregullimeve të stresit post-traumatik që zgjasin dhe përsëriten është e zakonshme. Prandaj, zbulimi i hershëm i indikatorëve/shenjave që çojnë në supozimin se një fëmijë është viktimë e mundshme e trafikimit të fëmijëve është aktiviteti themelor në parandalimin e tij.

3. INDIKATORËT E ZBULIMIT DHE IDENTIFIKIMIT PRELIMINAR TË FËMIJËVE- VIKTIMA POTENCIALE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Zbulimi i hershëm i viktimave të mundshme ose viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është baza për reduktimin e cenueshmërisë dhe ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat. Për këtë qëllim, përdoren shumë indikatorë që çojnë në supozimin se një person është viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore. Indikatorët janë një “mekanizëm” i mirë që ndihmon punonjësit e sistemit arsimor në mënyrë strukturore dhe funksionale, në mënyrë sistematike për të kontrolluar atë që kanë vërejtur tek ndonjë nxënës, që mund të ndërlihet me trafikimin

e fëmijëve dhe që lehtëson veprimin e mëtutjeshëm për referimin dhe mbrojtjen e viktimave. Njohja e tyre ia mundëson mësimdhënësit/bashkëpunëtorit profesionist të dyshojë, por edhe ta konfirmojë dyshimin se nxënësi, tek e cila/ i cili janë vërejtur disa nga këto shenja/indikatorë, a është apo jo viktimë potenciale e trafikimit.

Identifikimi paraprak i viktimave të mundshme të trafikimit të fëmijëve

Identifikimi paraprak i viktimave të mundshme të trafikimit të fëmijëve përfshin vlerësimin se a ka prani të indikatorëve të trafikimit të fëmijëve në kontaktin e parë me viktimën e mundshme. Ky proces identifikimi përfshin **përcaktimin e nivelit të rrezikut** që fëmija të jetë viktimë e mundshme. Megjithatë, kjo nuk konfirmon që fëmija është në të vërtetë viktimë e trafikimit.

Për të konfirmuar që një fëmijë është viktimë e trafikimit, është e nevojshme të vërtetohet se fëmija është shfrytëzuar ose rekrutuar për qëllime shfrytëzimi për të përfituar dobi pasurore të paligjshme. Ky proces identifikimi zakonisht kryhet nga punëtorët socialë dhe/ose forcat e rendit.

Organizatrat ndërkombëtare dhe qytetare kanë zhvilluar grupe të ndryshme indikatorësh për të mbështetur identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit nga profesionistë, si: policia, inspektorët e punës, punëtorët socialë dhe mësimdhënësit.

Indikatorët për identifikimin e viktimave të trafikimit të fëmijëve grupohen në dy kategori kryesore:

- A.** Indikatorë të veçantë për identifikimin e fëmijëve të cilët janë viktima të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore.
- B.** Indikatorë specifikë për identifikimin e fëmijëve viktima të një lloji të caktuar të trafikimit të fëmijëve.

Megjithëse nuk ka indikatorë plotësisht tipik për secilin lloj të trafikimit të fëmijëve, këto grupe indikatorësh ofrojnë udhëzime të vlefshme për profesionistët në zbulimin e viktimave të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore mes fëmijëve. Informata të mëtejshme mbi këta indikatorë gjenden në shtojcë.

A. Indikatorët (treguesit) e veçantë për identifikimin e fëmijëve të cilët janë viktima të mundshme të trafikimit

1. SHENJAT E ABUZIMIT FIZIK

Fëmijët kanë:

- shenja të punës së rëndë fizike, (duar të ashpra, fluska),
- lëndime që nuk janë në përputhje me shpjegimet e shkaqeve,
- shpjegime të palogjikshme se si janë shkaktuar lëndimet,
- ndryshime të shpeshta në shëndetin fizik,
- dhimbje koke të shpeshta, dhimbje barku të shpeshta,
- pamje e lënë pas dore, e/i uritur, e/i çrregullt,
- shenja të lodhjes së vazhdueshme (fizike),
- lëndime simetrike (lëndime të cilat janë të njëjta në të dy krahët ose në pjesë të kundërta të trupit),
- lëndime të shumta, në faza të ndryshme të shërimit dhe
- lëndime të kamufluara me rroba.

2. SHENJAT E ABUZIMIT PSIKOLOGJIK

Fëmijët:

- duken të stepur, pasiv, të pasigurt dhe të pashpresë,
- i shmangen kontaktin “sy me sy”,
- manifestojnë agresivitet
- tërhiqen dhe izoloohen,

- manifestojnë depresion, frikë dhe ankth,
- manifestojnë përgjumje, ndodh që të flenë në orën e mësimit,
- manifestojnë lodhje psikologjike,
- duken të lodhur, të hutuar,
- duken të turpshëm,
- vështirë i kontrollojnë emocionet – hidhërimin, zemërimin, mllëfin dhe përgjërimin,
- manifestojnë frikë ose shqetësim,
- kanë shenja të mungesës së orientimit, përhumbjes, fobisë e sulmeve të panikut, si dhe
- janë të dezorientuar në kohë dhe hapësirë.

3. SJELLJA E FËMIJËS SI INDIKATOR (TREGUES)

Fëmijët:

- manifestojnë ndryshime të papritura e të dukshme në sjelljen e tyre (nga qetësia papritur kalojnë deri në gjendje të shprehur ankthi),
- manifestojnë ndjenjë faji për situatën e tyre,
- manifestojnë shenja abuzimi të mjeteve qetësuese ose mjeteve të cilat krijojnë varësi,
- manifestojnë sjellje paranoike,
- manifestojnë sjellje nënshtruese,
- i shmangen bisedës së drejtpërdrejt,
- japin deklarime kundërthënëse, gjysmake ose të pavërteta,
- janë pasiv ose hiperaktiv,
- nuk kanë besim te askush,
- i shmangen bisedës për situatën në të cilën gjenden,
- nuk mund të krijojnë dhe të kenë marrëdhënie miqësore me moshatarët,
- nuk kanë miq të moshës së tyre,

- nuk janë të interesuar për të mësuar,
- shkelin ligjin (konflikti me policinë),
- manifestojnë luhatje sa i përket përqendrimit – shpërqendrim,
- nuk mund të përqendrohen në procesin mësimor,
- shpeshherë vonohen në shkollë dhe mungojnë nga shkolla (veçanërisht në periudhën e punëve sezonale),
- nuk japin sqarime pse vonohen, refuzojnë të përgjigjen ose të japin përgjigje të cilat dukshëm janë të pasakta,
- kanë vështirësi gjatë mësimit dhe e ulin suksesin,
- nuk i bëjnë detyrat e shtëpisë,
- manifestojnë prirje për sjellje të rrezikshme dhe të kundërligjshme,
- nuk marrin pjesë në aktivitete jashtëmësimore,
- në mbledhjet prindërore nuk merr pjesë prindi/kujdestari.

Zakonisht, këto ndryshime në sjellje mund të ngrenë dyshime se nxënësi mund të jetë viktimë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore, por mund të jenë edhe tregues i një problemi tjetër me nxënësin, për shembull, dhunë në familje ose shfrytëzim i një lloji tjetër.

Megjithatë, ekzistenca e secilit prej këtyre treguesve kërkon kujdes më të madh nga ana e mësimitdhënësve për shkak të mundësisë së trafikimit të fëmijëve.

Është e nevojshme të zbulohen të paktën tre tregues për të ngritur dyshimin se nxënësi është viktimë e mundshme e trafikimit të fëmijëve.

Gjithashtu, është jashtëzakonisht e rëndësishme që mësimitdhënësit e shkollave të jenë të informuar, por edhe të ndërgjegjshëm, se trafikimi i fëmijëve mund të jetë edhe një shkak i mundshëm për ndryshim në sjelljen e nxënësve të tyre, në mënyrë që ata të mund të konsultohen në momentin e duhur me profesionistë të fushës, si dhe marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e viktimave nga situata të dëmshme. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ndryshimet në sjelljen e fëmijëve duhet të përcaktohen

automatikisht si rezultat i trafikimit të fëmijëve, në të cilin rast mund të anashkalohen shkaqe të tjera të mundshme, si dhuna në familje etj. Në vend të kësaj, mësimdhënësi duhet të jetë më i kujdesshëm për ekzistencën e mundësisë së trafikimit të fëmijëve. Nëse nuk bëhet fjalë për trafikim të fëmijëve, atëherë prania e këtyre treguesve mund të tregojë se fëmija po përballet me probleme të tjera dhe ka nevojë për ndihmë dhe mbështetje profesionale.

B. Indikatorët (treguesit) e veçantë për identifikimin e fëmijëve-viktima të një lloji të caktuar të trafikimit të fëmijëve

1. INDIKATORËT (TREGUESIT) E SHFRYTËZIMIT TË FËMIJËVE PËR PUNË

Karakteristikat tipike të kushteve të punës ku fëmijët, viktima të trafikimit, shfrytëzohen për punën e tyre:

- punojnë në ferma/stane blegtorale, në ekonomitë bujqësore, sallone për masazh, objekte hotelerie, klube të natës, fabrika, uzina, miniera dhe plantazhe,
- kryejnë shërbime nën kërcënim dhe pa pëlqim,
- shfrytëzojnë pajisje dhe vegla të cilat nuk janë të përshtatshme që fëmijët të punojnë me to,
- lëvizja e tyre kontrollohet nga persona të tjerë,
- punojnë punë të papërshtatshme dhe në kushte të papërshtatshme për moshën e tyre; më shumë orë pune, pa pushim dhe pa kohë të lirë, pa rrespektimin e dispozitave ligjore,
- disiplinohen përmes dhunës fizike, dënimeve monetare, kanë shujta dhe lëvizje të kufizuara, dhe
- nuk guxojnë të largohen nga puna, përkatësisht nga “pronari”.

2. INDIKATORËT (TREGUESIT) E FËMIJËVE QË DETYROHEN TË LYPIN

Fëmijët viktimë të trafikimit me qëllim të kërkimit të lëmshës:

- fëmijë në moshë të ndryshme (në moshë parashkollorë, shkollorë dhe adoleshente),
- fëmijë me aftësi të kufizuara (më së shpeshti me pengesa fizike),
- mund të ketë lëndime fizike që duket se janë bërë me dashje,
- këmbëngulës gjatë kërkimit të lëmshës, pa dallim të kushteve klimatike,
- vëzhgohen/kontrollohen vazhdimisht në një distancë të caktuar nga persona të tjerë.

3. INDIKATORËT (TREGUESIT) E TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE QË SHFRYTËZOHEN PËR KRYERJEN E VEPRAVE PENALE

Fëmijët e trafikuar me qëllim të kryerjes së krimeve:

- detyrohen të kryejnë akte të vjedhjes,
- ndëshkohen nëse nuk arrijnë të "mbledhin" ose vjedhin mjaftueshëm para,
- merren me shpërndarjen dhe shitjen e mjeteve të palejueshme; substancave narkotike, armëve dhe gjësëndeve të vjedhura,
- për të cilët ka informacione për përfshirjen e tyre paraprake në ndonjë krim të ngjashëm në një shtet/vend tjetër,

4. INDIKATORËT (TREGUESIT) E SHFRYTËZIMIT SEKSUAL:

Fëmijë-viktima të shfrytëzimit seksual:

- më së shpeshti janë vajza të moshës prej 12 deri 18 vjet,
- punojnë në kafene, hotele, motele, sallone për masazh,
- nuk guxojnë ta refuzojnë urdhrin për t'i shërbyer klientit,
- nuk guxojnë të largohen nga "puna" përkatësisht nga "pronari".
- shoqërohen nga persona të cilët i kontrollojnë,

- ndonjëherë i nënshtrohen seksit të dhunshëm,
- për të cilët ekzistojnë parashenja se janë viktima të incestit,
- refuzojnë të flasin për abuzimin seksual.

5. INDIKATORËT (TREGUESIT) E TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE-VIKTIMA TË SKLLAVËRISË NË SHITËPI:

Fëmijët- viktima të skllavërisë:

- jetojnë në familje ku edhe shfrytëzohen,
- angazhohen të punojnë punë jo-përkatëse,
- ushqehen ndaras nga anëtarët e familjes,
- ushqehen me mbetjet e ushqimit,
- nuk kanë hapësirë private dhe flenë në hapësira jo-përkatëse,
- asnjëherë nuk dalin vet dhe nuk komunikojnë me persona të tjerë nga fqinjësia,
- u nënshtrohen ofendimeve, keqtrajtimeve, kërcënimeve dhe dhunës,
- disiplinohen përmes dënimeve fizike,
- nuk kanë liri ta braktisin familjen.

6. INDIKATORËT (TREGUESIT) E FËMIJËVE TË CILËT JANË VIKTIMA TË MARTESËS SË DETYRUESHME “NUSE ME POROSI”

Martetat e detyrueshme të fëmijëve karakterizohen me:

- rekrutimin e fëmijëve përmes prindërve, familjarëve dhe personave të tjerë për “lidhje të martesës” jashtë vendit,
- premtime të rrejshme dhe mashtrime për një jetë më të mirë dhe më të pasur,
- organizimin e “dasmës” pa prezencën e dhëndrit,
- nënshtrimin e fëmijëve ndaj shumë llojeve të shfrytëzimit, veçanërisht ndaj shfrytëzimit seksual,
- lypësi, vjedhje, skllavëri,
- dhunë fizike dhe psikologjike nga ana e anëtarëve të familjes.



4. ROLI I SHKOLLËS NË PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Shkolla është institucioni i cili e ka për detyrë t'u sigurojë kushte për rritje dhe zhvillim të sigurt të nxënësve dhe mbrojtje nga të gjitha llojet e dhunës, abuzimit dhe shpërfilljes. Forma më e rëndë e dhunës dhe veprës penale ndaj të cilës fëmijët dhe të rinjtë mund të ekspozohen është trafikimi i qenieve njerëzore, dukuri kjo e cila për fat të keq vite me radhë është e pranishme në suaza botërore por edhe tek ne.

Të gjitha institucionet shtetërore dhe shoqëria civile janë përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve/nxënësve. Në mesin e institucioneve rol të rëndësishëm ka edhe shkolla. Për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve/nxënësve nga trafikimi i qenieve njerëzore në kontekst të shkollës, kërkohet angazhim i drejtorit, mësime dhënëse, bashkëpunëtorëve profesionistë, prindërve si dhe mekanizmave të tjerë që veprojnë brenda saj.

Andaj, është e rëndësishme që të gjitha subjektet brenda shkollës të njohin problemin e trafikimit të qenieve njerëzore/fëmijëve, mënyrat e

identifikimit të hershëm të fëmijëve viktima potenciale dhe referimin e tyre në institucionet përgjegjëse kompetente. Njohuritë më të mira dhe trajnimi i kuadrit mësimor lidhur me trafikimin e fëmijëve në masë të konsiderueshme do të ndikojë në parandalimin dhe luftimin e tij tek fëmijët dhe më gjerë në shoqëri.

Ndërlikueshmëria e fenomenit të trafikimit të fëmijëve kërkon ndërgjegjësim të plotë, trajnim dhe fuqizim të kapaciteteve të një vargu të institucioneve, prej të cilave kur bëhet fjalë për fëmijë, më e rëndësishmja është shkolla.

Në këtë linjë personeli dhe mekanizmat e shkollës duhet të punojnë në parandalimin e trafikimit, identifikimin, raportimin dhe ri-integrimin e nxënësve viktima.

Cilat janë detyrimet e shkollës në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve?

Detyrimet e shkollës në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të fëmijëve janë:

- njohja dhe mbikëqyrja e shenjave të hershme që tregojnë trafikim të mundshëm njerëzor;
- mbështetja e fëmijës në procesin e ri-integrimit në shkollë, por edhe në mjedis;
- bashkëpunimi me organet dhe institucionet përgjegjëse për identifikimin dhe mbështetjen e fëmijëve -viktima të trafikimit të qenieve njerëzore.

Shkolla i përmbush këto detyrime nëpërmjet:

- monitorimit të vazhdueshëm të ndryshimeve tek fëmijët;
- aplikimit të treguesve për identifikimin paraprak të fëmijëve viktima të mundshme;
- informimit të qendrës kompetente të ndihmës sociale, policisë dhe prindërve/kujdestarëve.

Në luftimin e trafikimit të fëmijëve, shkolla ka në dispozicion dy mekanizma, përkatësisht: parandalimin dhe ndërhyrjen.

5. PARANDALIMI

Parandalimi bëhet duke trajtuar temën e trafikimit gjatë procesit mësimor me qasje kurrikulare, ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare. Trajtimi efikas i kësaj teme gjatë mësimdhënies i aftëson fëmijët që t`u shmangen rreziqeve, të dinë si të sillen në situatat e ndryshme jetësore, si dhe të promovojnë qëndrime, vlera dhe sjellje të shëndetshme në raport me moshatarët e tyre, rrethin dhe shoqërinë në tërësi.

Qasje kurrikulare

Tema e trafikimit trajtohet në lëndët mësimore të cilat e kanë pjesë të programit mësimor, kryesisht lëndët që dalin nga fusha kurrikulare “Shoqëria dhe mjedisi”, aktivitetet mësimore bëhen pjesë e planeve të punës së mësimdhënësve, në përputhje me dokumentet kurrikulare dhe programet lëndore.

Qasja ndërkurrikulare

Tema e trafikimit trajtohet te çështja ndërkurrikulare, ku mësimdhënësit obligohen t`a ndërlidhin me lëndët e tyre mësimore. Gjithashtu kjo bëhet pjesë e planifikimit të rregullt.

Qasja jashtëkurrikulare

Mësimdhënësit dhe personeli tjetër i shkollës mund të organizojnë projekte, aktivitete sensibilizuese për këtë temë, në bashkëveprim me institucione të tjera dhe komunitetin, brenda planifikimeve të aktiviteteve profesionale dhe qeverisjes së shkollës. Aktivitetet mund të jenë të larmishme, si: ligjërata, debate, ekspozita, teatër, aktivitete garuese, vizita të ndryshme, etj.

Mësimdhënia cilësore ndikon në vetëdijesimin e fëmijëve/nxënësve për rreziqet nga trafikimi dhe si të sillen ndaj rrethanave dhe situatave të caktuara sfiduese, duke favorizuar mbrojtjen e tyre në kontekst të shkollës.

Për të forcuar parandalimin e trafikimit nëpërmjet mësimdhënies, mund të përdoren materiale mësimore, informuese, ligjore dhe statistikore, të përgatitura nga MASHT, ministritë e tjera, organizatat dhe agjencionet e ndryshme kredibile.

Identifikimi

Identifikimi i hershëm i fëmijëve/nxënësve që mund të jenë të rrezikuar apo të përfshirë në trafikim është i domosdoshëm për të shmangur rrezikun nga trafikimi.

Mësimdhënësit, meqë kalojnë shumicën e kohës me nxënësit e tyre, janë personat e parë që mund të kontribuojnë identifikimit të fëmijëve që mund të jenë pre e trafikimit. Gjithsesi edhe personeli tjetër i shkollës (administrativ dhe profesional) ka detyrim dhe mundësi të identifikimit.

Shenjat dhe sjelljet që ndihmojnë në identifikimin e hershëm janë:

- rënia e menjëhershme e suksesit në mësim;
- mungesa e përqendrimit në mësim;
- mungesat dhe vonesat e paarsyeshme;
- ndryshimet në qëndrime;
- sjellja antishoqërore;
- mospranimi për bashkëveprim social;
- pranimi i dhuratave të pajustificueshme;
- shenja të dukshme të dhunës fizike (njolla, kafshime, lëndime të tjera fizike etj.);
- shenja ankthi, frike;
- shoqërimi me persona të moshës madhore (edhe gjatë vajtje-ardhjes për në shkollë);
- shenja të tërheqjes dhe të izolimit;
- angazhohet në punë që nuk janë të përshtatshme për moshën;
- shkëputja e menjëhershme nga familjarët dhe nga shoqëritë afatgjata;
- ndryshimi i identitetit në rrjetet sociale;
- vetëbesimi i ulët, etj.

Kur dyshohet për raste të trafikimit, shkolla ndërmerr veprime ndërhyrëse, që nga faza e raportimit e tutje.

Raportimi

Referimi dhe raportimi-lajmërimi i rasteve që janë pre e trafikimit është detyrim ligjor dhe domosdoshmëri. Moslajmërimi është veprë penale.

Sipas legjislacionit në fuqi, mësimdhënësit si çdo qytetar dhe person tjetër juridik e profesional, duhet të raportojnë rastin, kur ekziston dyshim i arsyeshëm se fëmija është viktimë e veprës penale.

Rastet kur fillojnë të trajtohen brenda shkollës për shkak të dyshimit, duhet të evidentohen në sistem SMIA (Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim), varësisht nga statusi i tyre, qoftë në modulën e dhunës, apo në atë të paralajmërimit të hershëm të braktisjes (raportimi dhe referimi i rasteve në këto module ndihmon trajtimin efikas edhe të rasteve të trafikimit). Trajtimi i rasteve gjithsesi duhet të bëhet në bashkëpunim me prindin ose kujdestarin ligjor.

Kur këto raste dalin jashtë kompetencës së shkollës për trajtim, raportohen në institucionet e tjera përgjegjëse, sipas procedurave standarde të veprimit për viktimat e trafikimit (Polici, qendër për punë sociale, institucione shëndetësore etj.).

Ri-integrimi

Kur viktimat të kenë mbaruar programin e mbrojtjes dhe rehabilitimit, si dhe të jenë të gatshëm për t'u integruar në arsim, mekanizmat e sistemit arsimor i ri-integrojnë ata bazuar në legjislacionin në fuqi.

Kur viktimat rikthen në shkollë, duhet të mbështeten nga mësimdhënësit, dhe stafi tjetër i shkollës dhe u sigurohet:

- Mbrojtje e privatësisë;
- Shmangie e stigmatizimit;
- Klimë miqësore; dhe
- Aktivitete psiko-sociale.

Ata duhet të monitorohen (përcillen) për të shmangur ri-viktimizimin, duke marrë parasysh këto elemente:

- A vijojnë rregullisht mësimin?
- Me kë po miqësohen? Sa lidhje të forta kanë?
- A ka ndonjë ndryshim të madh në moshë mes tyre dhe personave me të cilët shoqërohen?
- A duket te jetë e shëndetshme marrëdhënia me personat që shoqërohen? (A është ndonjë lider i dukshëm)?
- A kanë humbur miq të vjetër apo a kanë gjetur të rinj?
- A qëndrojnë të veçuar nga të tjerët gjatë pushimit?
- A shkaktojnë probleme në klasë apo janë të tërhequr?
- A janë shkëputur nga aktivitetet në shkollë?
- A janë shkëputur nga aktivitetet sociale?
- Cili është rezultati në mësim?
- A ka shenja që tregojnë se ata duan të vetë-përrjashtohen nga shkolla?

Këto pyetje dhe jo vetëm janë ndihmesë për mësimdhënësin dhe personelin tjetër të shkollës, për të përcjellur sjelljet e fëmijës pas ri-integrimit. Në rast se vërehet sjellje që fëmijën/nxënësin e çojnë në rrezik për viktimizim, atëherë duhet ndjekur sërish procedurat e njëjta të raportimit, referimit dhe trajtimit, sipas hierarkisë institucionale, bazuar në 'Procedurat Standarde të Veprimit'. Veprimi i mësimdhënësve dhe personelit tjetër të shkollës, në parandalim, identifikim raportim dhe ri-integrim përpos që është detyrim ligjor është dhe përgjegjësi institucionale. Qasja proaktive e institucionit edukativo-arsimor mbron fëmijët nga çdo element i rrezikshëm që cenon zhvillimin e tyre të plotë, fizik, intelektual, emocional e social dhe ndikon në të ardhmen e fëmijëve, familjeve, shoqërisë dhe shtetit tonë.

6. PROCEDURAT E DENONCIMIT TË RASTIT KUR EKZISTON DYSHIMI SE EKZISTON VIKTIMA POTENCIALE E TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Kur ekziston dyshimi se një nxënës mund të jetë viktimë e mundshme e trafikimit të fëmijëve, shkolla ka disa detyrime për të siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien e tyre. Këto detyrime përfshijnë:

- Identifikimin e nxënësve- viktima potenciale të trafikimit të fëmijëve dhe bashkëpunimin me institucionet dhe autoritetet kompetente për t'i mbështetur ata, si: Qendra për Punë Sociale dhe Policia.
- Sigurimin që fëmija të shoqërohet në shkollë dhe të përfshihet në procesin edukativo-arsimor nëse ai/ajo e ka ndërprerë shkollën dhe të mbështesë integrimin e tij/saj në sistemin arsimor.

Nëse mësimitdhënësi ose punonjësi tjetër i shkollës vëren tregues se një fëmijë mund të jetë viktimë e mundshme e trafikimit të fëmijëve, ata duhet të ndjekin procedurën e njoftimit dhe referimit të përshkruar më poshtë.

Detyrimet themelore të shkollës gjatë zbulimit dhe referimit të viktimave potenciale të trafikimit të qenieve njerëzore janë:

- Identifikimi paraprak i nxënësve viktimë të mundshme të trafikimit të fëmijëve;
- Bashkëpunimi me institucionet dhe autoritetet kompetente për identifikimin dhe mbështetjen e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, siç është Qendra për Punë Sociale dhe Policia; dhe
- Mbështetja e fëmijëve në shkollë, përfshirja në procesin edukativo-arsimor nëse ai/ajo e ka ndërprerë shkollën dhe mbështetja e integritetit të tyre në sistemin arsimor.

Nëse mësimitdhënësi e vëren prezencën e ndonjërit të indikatorëve se ndonjë fëmijë është viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve, atëherë procedura e njoftimit dhe referimit doemos duhet të ndiqet.

Denoncimi i rastit dhe referimi

Në rastet kur mësimitdhënësi ose punonjësit e tjerë në shkollë tek fëmija do të vërejnë shenja ndryshimi në të nxënësit, të sjelljes dhe gjendjes shëndetësore, të cilat mund të shkaktojnë dyshime se nxënësi, sipas një numri të caktuar të indikatorëve, është viktimë potenciale e trafikimit të fëmijëve, menjëherë duhet ta informojnë personin përgjegjës, i cili pastaj e informon drejtorin e shkollës.

Ku raportohet rasti:

Procedurat e raportimit në rastin e fëmijëve- viktimat të dyshuara të trafikimit duhet të ndjekin një protokoll të rreptë, për të garantuar kështu mbrojtjen e interesave të fëmijës. Këto procedura janë përshkruar më poshtë:

1. IDENTIFIKIMI PARAPRAK

Shkolla është e detyruar të identifikojë viktimat e mundshme të trafikimit të fëmijëve. Nëse mësimdhënësi vëren shenja ose tregues se një fëmijë mund të jetë viktimë e mundshme, ata duhet të ndjekin procedurën e njoftimit dhe referimit.

2. NJOFTIMI DHE REFERIMI

Personi përgjegjës duhet të njoftohet menjëherë. Më pas duhet ta informojnë drejtorin e shkollës, i cili do ta raportojë rastin në Qendrën për Punë Sociale dhe në Polici, nëse është e nevojshme. I gjithë informacioni në dispozicion, duke përfshirë faktet dhe rrethanat në lidhje me rastin, duhet t'u jepen me shkrim autoriteteve kompetente.

3. PËRFSHIRJA E PRINDËRVE/KUJDESTARËVE

Menjëherë duhet të njoftohen prindërit/kujdestarët e fëmijës/nxënësit për ndryshimet e zbuluara në sjelljen e fëmijës si dhe për veprimet e ndërmarra nga ana e institucioneve përkatëse.

4. DOKUMENTIMI

Zyrtari i shkollës duhet të mbajë shënime zyrtare për të gjitha bisedat, letrat e shkëmbyera dhe çdo informacion tjetër shtesë në lidhje me rastin.

5. BASHKËPUNIMI ME QENDRËN PËR PUNË SOCIALE

Shkolla duhet të bashkëpunojë me ekipin profesional të Qendrës për Punë Sociale dhe të marrë pjesë në hartimin e një plani dhe programi individual për mbrojtjen e fëmijës.

6. KOMUNIKIMI NDËRMJET INSTITUCIONEVE

Institucionet kompetente, përfshirë shkollën, personin përgjegjës, Qendrën për Punë Sociale dhe Policinë, duhet të informojnë njëra-tjetrën për të gjitha kushtet e vërejtura dhe aktivitetet e ndërmarra. Ata gjithashtu duhet të marrin pjesë në procedurat e mëtejshme në përputhje me planin dhe programin individual për trajtimin e fëmijës të hartuar nga Qendra për Punë Sociale. 7. Dokumentacioni për vendim gjyqësor

Me kërkesë të prokurorisë ose policisë, institucioni arsimor menjëherë ua dërgon dokumentacionin e plotë që ka të bëjë me rastin e evidentuar me qëllim të zgjidhjes së shpejtë dhe efikase gjyqësore të të njëjtit.

Është me rëndësi të theksohet se çdo dyshim duhet t'i paraqitet personit ose institucionit të ngarkuar me identifikimin e fëmijëve viktimë të trafikimit të fëmijëve, që është Qendra për Punë Sociale. Procedura duhet të jetë e shpejtë, e besueshme dhe në drejtim të mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës.

Është me rëndësi të theksohet se çdo dyshim duhet të paraqitet te personi ose institucioni përgjegjës për identifikimin e fëmijëve- viktimë të trafikimit të fëmijëve - Qendra për Punë Sociale.

Numrat kontaktues për referim

Emri i institucionit Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave	Kontakti/Linja emergjente pa pagesë Tel.: 0800 11112
Policia e Kosovës Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore.	Tel.: 192 email: antitrafikimi@kosovopolic.com

Korniza Ligjore në fushën a parandalimit të Trafikimit me Njerëz në Kosovë

Legjislacioni Kombëtar

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur;
- Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikuar;
- Ligji për kompensimin e viktimave të krimit;
- Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje;
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike;
- Ligji për Inspektoratin e Punës;
- Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë;
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Strategjia për të drejtat e fëmijëve;
- Ligji Nr. 04/L-081 për Amandamentimin dhe Plotësimin e ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare;
- Ligji për Familje, 2004/32;
- Ligji mbi Ndërprerjen e Shtatzënisë, 2008/03-L-110;
- Ligji i Punës;
- Ligji për Ndihmë Juridike Falas;
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji për Aftësim Profesional, Rehabilitim dhe Punësim të Personave me Nevoja të Veçanta;
- Ligji kundër Diskriminimit;
- Ligji për Barazi Gjinore;
- Ligji për të Huaj;

- Ligji për Azil;
- Ligji për Lëshimin e Lejes së Punës dhe Punësim të Qytetarëve të Huaj në Kosovë.

Legjislacioni Ndërkombëtar

- 2006 Konventa për të Drejtat e Personave me Nevoja të Veçanta dhe Protokolli i saj Opsional;
- 2006 Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtje të të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë;
- 2000 Protokolli për të Parandaluar, Shtypur dhe Ndëshkuar Trafikimin me

Njerëz sidomos të Grave dhe Fëmijëve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndër-nacional;

- 2000 Protokolli Opsional për Konventën e të Drejtave të Fëmijës për Shitje, Prostitutum të Fëmijëve;
- 1999 Konventa e ONP për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve Nr. 182;
- 1990 Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave e të Gjithë Punëtorëve Emigrant dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre;
- 1989 Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- 1984 Konventa Kundër Torturës, Trajtimeve dhe Ndëshkimeve të tjera të Egra, Jonjerëzore apo Degraduese;
- 1979 Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave;
- 1967 Protokoll për Statusin e Refugjatëve;

- Procedurat Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar në Kosovë
- 1966 Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- 1966 Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- 1966 Protokollin Opsional për Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike;
- 1957 Konventa e ONP për Shfuqizimin e Punës së Detyruar
- 1951 Konventa për Statusin e Refugjatit;
- 1930 Konventa e ONP për Punë të Detyruar Nr. 130;
- 2011 Konventa për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, CETS nr.210, 7 prill 2011;
- 2007 Konventa për Mbrojtjen e Fëmijës kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Keqtrajtimit Seksual;
- 2005 Konventa për Veprim Kundër Trafikimit me Njerëz, CETS nr. 197, 16 maj 2005;
- 1983 Konventa për Kompensim të Viktimave të Krimeve të Dhunshme, CETS nr. 116, 24 nëntor 1983;
- 1981 Konventa për mbrojtje të individëve rreth procesimit automatik të të dhënave personale, ETS 108, 28.1.1981;
- 1950 Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, siç është amandamentuar me Protokollin Nr. 11,04.11.1950;
- 2010 Direktiva për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Tij, Gazeta Zyrtare L 101/1 15.04.2011;
- 2008 Vendimi Kornizë i Këshillit 2008/977/JHA e datës 27 nëntor 2008 për mbrojtjen e të dhënave personale të procesuara në kornizën e bashkëpunimit të policisë dhe gjyqësorit për çështje penale;

- 2004 Direktiva e Këshillit 2004/81/KE e datës 29 prill 2004 për leje rezidenciale për qytetarët e vendeve të treta që janë viktime të trafikimit me njerëz apo të cilët kanë qenë objekt i një veprimi për lehtësimin e imigrimit ilegal, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente, Gazeta Zyrtare L 261, 06 gusht 2004;
- 2002 Direktiva 2002/58/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 qershor 2002 lidhur me procesimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike, Gazeta Zyrtare L 201/37, 31 korrik 2002;
- 2001 Vendimi Kornizë i Këshillit i 15 marsit 2001 për qëndrimin e viktimave në procedura kriminale (2001/220/JHA);
- 2000 Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, Gazeta Zyrtare C 303 e 14 dhjetorit 2007;
- 1995 Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve lidhur me procesimin e të dhënave personale dhe për lëvizje të lirë të të dhënave të tilla, Gazeta Zyrtare L 281, 23 nëntor 1995.

